

**AKT THEMELIMI**  
***Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar***  
***“DOLCE VITA EASTERN EUROPE” SH.P.K.***

Sot, më datën 21.02.2024, **Z. FRANCESCO PITTURERI** i lindur në Bologna, Itali më datë 09 Gusht 1981 mbajtës i letërnjoftimit me numër personal AY4591263, banues në Bassano del Grappa, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“DOLCE VITA EASTERN EUROPE” Sh. P. K.** si më poshtë vijon

**Neni 1**

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin **“DOLCE VITA EASTERN EUROPE” shpk.**

Ortak i kësaj shoqërie është **Z. FRANCESCO PITTURERI.**

Administratore i kësaj shoqërie caktohet **Z. FRANCESCO PITTURERI**, shtetas italian, lindur në Itali me 09 Gusht 1981, i pajisur me NID nr. AY4591263. Z.Pittureri emerohet administrator i shoqërisë për një periudhë 5 vjecare.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria **“DOLCE VITA EASTERN EUROPE” SH.P.K** gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Sh.P.K.”**. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë **“DOLCE VITA EASTERN EUROPE” SH.P.K.** është: DURRES Lagja 04, Rruga “Fetah Bllaca”, Pallati nr. 1133, Zona Kadastrale 8514, Kati i tretë.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Import-eksport i mallrave ushqimore, biokimik, industriale, lëndë e parë.
- Tregti me shumicë e pakicë e mallrave ushqimore dhe industriale.
- Konsulencë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit.
- Konsulencë në fushën e manaxhimit teknologjik.
- Investime në pasuri të paluajtshme. Import, eksport makinerish prodhimi dhe pjesë këmbimi.
- Dhënie me qira.
- Hapje dhe zhvillimi i aktiviteteve në fushën e agjensive imobiliare, turizmit, transportit.
- Agjent tregtar.
- Agjensi përfaqësimi.



#### **Neni 5**

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

- **Z. FRANCESCO PITTURERI** zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tregëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**FRANCESCO PITTURERI**

